



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 111/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Agron Salihu anëtarë i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të ndikimit tek votuesit gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05. 2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga subjekti politik LVV, dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se me datën 29.04.2012 gjatë tërë ditës në shkollën “Ahmet Hoxha” kanë qëndruar dy persona civil duke bërë presion tek qytetarët që të votojnë numrin 26. Sipas parashtruesit të ankesës njëri nga këta civil quhet Agron Salihu (Zogu) me prejardhje nga Talinoci me një shenjë në fytyrë. Ky rast sipas parashtruesit të ankesës është raportuar nga një qytetar në zyre të LVV-së në Ferizaj, duke treguar që Agron Salihu (Zogu) ka marrë letërnjoftimin posa ka hyrë në QV 2501 dhe e ka përcjell deri në vendvotim dhe i ka thënë që të votoj numrin 26 duke ia bërë me shenja të gishtërinjve “ të vras”. Ky person është vërejtur edhe nga shoqëria civile dhe vëzhguesit e komisionarët tanë. Me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës është shkelur neni 177 i Kodit penal.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 01.05.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 02.05.2012, në ora 14:00. PZAP, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar e ku thekson se 2 personat civil për të cilët pretendohet se kanë bërë presion mbi qytetarët nuk qëndron si dhe personi i paraqitur në ankesë me emrin Agron Salihu nuk është as komisionar e as vëzhgues i PDK-s, pasi që ne si strukturë e partisë PDK kemi bërë sensibilizimin e të gjithë anëtarëve dhe simpatizantëve që mos të shkelen rregullat zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

Ankuesi në ankesë pretendon se në vendvotimin 2501, Agron Salihu ka bërë presion në qytetarët për të votuar numrin 26. Ndërsa në raportin e policisë të datës 02.05.2012 të përgatitur nga oficerët Rasim Rushiti dhe Selvije Ismani theksohet se me datën 29.04.2012, e kemi kontaktuar drejtorin e kësaj shkolle njëkohësisht përgjegjës për këtë QV, i cili pohoi se gjithçka ka filluar në gjendje të rregullt. Po ashtu sipas raportit të policisë theksohet se gjatë kohës kur kanë votuar qytetarët kanë kontaktuar edhe me komisionarët dhe vëzhguesit në këtë qendër të cilët nuk kanë hasur ndonjë person që gjendet brenda shkollës pa dokument identifikues – bexh, dhe se askush deri në ora 17:00 sa kanë qenë në detyrë këta policë nuk kanë njoftuar për ndonjë problem eventual.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në raportin policor si dhe shkresat e lëndës gjeti se pretendimet ankimore në ankesë nuk qëndrojnë për faktin se pretendimet e tilla ankimore nuk janë të bazuara në dëshmi të qarta dhe bindëse, andaj duke marr parasysh këtë, një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazuar, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 111/2012 më datën 03.05.2012.

